

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Tonka Berishaj dhe Have Haliti, anëtare të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Bujar Bala, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarës S.H., nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprave penale-keqpërdorim i të drejtës së votimit nga neni 216 par. 1 nën par. 2 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën e mbrojtëses të akuzuarës S.H., av. F.B., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr. 105/2015 të datës 21.07.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK-së, me datën 29.09. 2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesa e mbrojtëses të akuzuarës S.H., av. F.B., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr. 105/2015 të datës 21.07.2017, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë me aktgjykimin P.nr. 105/2015 të datës 21.07.2017, të akuzuarën S.H., e ka shpallur fajtores për shkak të veprës penale- keqpërdorim i të drejtës së votimit nga neni 216 par. 1 nën par. 2 të KPRK dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara në afat prej një (1) viti nuk kryen vepër tjetër penale. E akuzuara është obliguar që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas vendimit të posaçëm të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 40 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

-Mbrojtsja e të akuzuarës S.H., av.F.B., për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarin ta liroj nga akuza.

Prokurori i Shtetit, me parashtresën PPA/I.nr.408/17, të dt.13.09.2017, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtëses së të akuzuarës, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, seancën e kolegjit e mbajti konformë dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, në mungesë të palëve pasi që kemi të bëjmë me aktgjykim me të cilin është shqiptuar dënim i kushtëzuar, andaj nuk është e nevojshme që palët të njoftohen.

Gjykata e Apelit, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar edhe sipas detyrës zyrtare konformë dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, atëherë Gjykata e Apelit, të njëjtin e vlerësoi në pajtim me dispozitën e nenit 394 par.1 të KPPK, sipas detyrës zyrtare dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale që kishin me kushtëzuar prishjen e tij.

Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike.

Në ankesë theksohet se gjykata e shkallës së parë, nuk e ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike. Pretendon se nuk ka prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se e njëjta ka kryer veprën penale për të cilën edhe është shpallur fajtores, ndërsa e akuzuara e ka mohuar faktin se ka votuar në mënyrën si përshkruhet në dispozitiv të aktgjykimit. Po ashtu thekson se në aktgjykimin e ankimuar si vendi i kryerjes së veprës penale precizohet shkolla fillore “Lumni Surdulli”, në fshatin ..., Komuna e Vushtrrisë, mirëpo, mirëpo në fshatin ..., nuk ka fare shkollë me emrin “Lumni Surdulli”, atëherë, sipas saj, shtrohet pyetja se si ka mundur e akuzuara të votoj qoftë me kusht apo e rregullt, apo të dyja në shkollën që nuk ekziston fare në fshatin

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e mësipërme ankimore janë të pabazuara. Nga shikimi i shkresave të lëndës dhe aktgjykimi i ankimuar rezulton se nuk ishte kontestues fakti se me dt.03.11.2013, në shkollën fillore “Lumni Surdulli”, në Vushtrri, në zgjedhjet lokale në vend votimin nr.2712B/02D, e akuzuara S.H., ka votuar njëherë si votuese me kusht. Këto rrethana përveç se nuk janë kontestuese nga palët në procedurë vërtetohen edhe nga provat materiale, lista e votuesve me kusht e cila edhe është nënshkruar nga e akuzuara, fakt ky që

vërtetohet edhe nga mbrojtja e të akuzuarës. Po ashtu nga lista e votuesve të rregullt rezultojnë në rubrikën e të dhënave personale të të akuzuarës S.H., është nënshkruar lista e votimit si votuese e rregullt me të njëjtën datë në vend votimin 2712B/02R. Ky fakt është vërtetuar edhe me ekspertizën grafologjike nga Agjencioni i Forenzikës së Kosovës, me të cilën është konstatuar se nënshkrimi në këtë listë të votuesve të rregullt në rubrikën e të pandehurës S.H., është vënë nga personi i njëjtë që ka nënshkruar edhe në listën e votuesve me kusht, në kopjen e zarfit të votimit me kusht dhe në mostrat e marra të nënshkrimeve nga e akuzuara. Prandaj, edhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, i drejtë është konkludimi i gjykatës së shkallës së parë, se nga provat materiale të përmendura pa dyshim vërtetohet fakti se e pandehura kishte votuar edhe si votuese e rregullt, pasi që kishte votuar si votuese me kusht dhe të gjitha arsyet që i ka dhënë gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar i aprovon edhe kjo gjykatë si të drejta dhe të ligjshme dhe nuk e sheh të arsyeshme që ti përsrisë vetëm për tu përgjigjur në pretendime ankimore.

Përkitazi me pretendimin ankimor se në përshkrimin faktik në dispozitiv të aktgjykimit është shënuar emri i shkollës fillore “Lumni Surdulli”, si vendi i kryerjes së veprës penale edhe pse kjo shkollë nuk ekziston në fshatin ..., është i pabazuar sepse kemi të bëjmë me një gabim teknik i cili nuk ndikon në vërtetimin e gjendjes faktike sepse në arsyetimin e aktgjykimit, por edhe nga shkresat e lëndës rezultojnë se kemi të bëjmë me shkollën fillore “Lumni Surdulli”, në Vushtrri, ndërsa numri i vendvotimit është i saktë dhe korrespondon me numrin e shënuar në zarfin e fletëvotimeve me kusht dhe listën e votuesve me kusht, si dhe me listën e votuesve të rregullt, të gjitha në emër të S.H.t.

Duke pasur parasysh gjendjen e vërtetuar faktike, të përmendur si më lartë dhe të përshkruar hollësisht në aktgjykimin e ankimuar, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka gjetur se në veprimet inkriminuese të të akuzuarës përmbushën tiparet e veprës penale–keqpërdorim i të drejtës së votimit nga neni 216 par. 1 nën par. 2 të KPRK-së, andaj drejtë ka zbatuar edhe ligjin penal.

Vendimi mbi sanksionin penal.

Përkitazi me bazën ankimore të vendimi mbi sanksionin penal, në ankesën e mbrojtëses të akuzuarës theksohet vetëm lartësia e dënimit është tejte e ashpër dhe nuk ka bazë ligjore.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, pretendimet e mbrojtëses të akuzuarës nuk janë të bazuara, sepse gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të llojit dhe masës së dënimit, i ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat, siç parashikohet me dispozitën e nenit 73 të KPRK, prandaj edhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit dënimi i shqiptuar të akuzuarës është në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të saj, si kryerëse, se është në funksion të preventivës së përgjithshme e posaçërisht të asaj individuale dhe se me këtë dënim do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPK-së. Në rrethana të këtilla nuk ekziston as asnjë arsye që të akuzuarës ti shqiptohet një dënim më i butë, siç pretendon

mbrojtësja, aq më parë kur në ankesë nuk thekson as një rrethanë që do të justifikon një dënim më të butë.

Nga çka u tha si me lartë konform nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.428/2017 i datës 29.09.2017

Procesmbajtësi:

Bujar Bala

Anëtarët e kolegjit:

Tonka Berishaj_____

Have Haliti _____

Kryetari i kolegjit:

Xhevdet Abazi